



INFORMACION PËR PRINDËRIT PËR PËRSHTATJEN E FËMIJËS ME KOPSHTIN MIRË SE VINI

Fillimi i kopshtit të fëmijëve është një hap i rëndësishëm në biografinë e çdo fëmije. Si një institucion arsimor fillor, kopshti i ofron fëmijës suaj një hapësirë të larmishme për të mësuar dhe fituar përvojë. Shumë gjëra do të jenë të reja: rrjedha e të përditshmes, mjediset, dhe mbi të gjitha fëmija juaj do të përfshihet në marrëdhënie të reja me fëmijë dhe me të rritur. Kohëzgjatja e fëmijës për të fituar këtë përvojë është e ndryshme – lërimi kohë fëmijës suaj.

Aktualisht, masat e parandalimit në kopshtet e fëmijëve do të zbatohen - në varësi të fazës së semaforit për Coronën. Në parim, gjatë periudhës së përshtatjes së fëmijës do të zbatohen rregullat e mëposhtme.

- ➔ Vetëm një person lejohet ta shoqërojë fëmijën.
- ➔ Personi shoqëruar mund të qëndrojë në dhomën e grupit me miratimin e personelit të kopshtit. Si prind / kujdestar ligjor, ju mund ta shoqëroni fëmijën tuaj në çdo fazë të semaforit gjatë periudhës së përshtatjes.
- ➔ Ne ju kërkohet, që të vëzhgoni dhe zbatoni me kujdes masat e mëposhtme parandaluese për Coronën, me qëllim që të gjithë të qëndrojnë të shëndetshëm dhe fëmijët të mund të luajnë dhe të mësojnë së bashku në kushte sa më "normale" të mundshme:

Gjatë fazës së GJELBËR të semaforit zbatohen rregullat si vijon:

Lani duart: të rriturve ju lutemi të dezinfektoni duart kur hyni në kopshtin e fëmijëve, fëmijët të lajnë duart para se të hyjnë në grupin pëkatës.

Mbani distancën: ju lutemi, vini re udhëzimet e mundshme dhe mbani distancën minimale. Të rriturit mbajnë distancën, kurse fëmijëve nuk do t'u kërkohet të mbajnë distancën.

Gjatë fazës së VERDHË të semaforit zbatohen rregullat si vijon:

Përsëri lani duart, mbani distancën

Mbulimi i gojës dhe hundës me maskë (MNS): për vizitorët (psh. prindërit, personat e jashtëm) mbajtja e maskës (MNS) në ambjentet e mbyllura është e detyrueshme. Fëmijët nuk mbajnë maskë (MNS).

Gjatë fazës PORTOKALLI të semaforit zbatohen rregullat si vijon:

Përsëri lani duart, mbani distancën, mbulimi i gojës dhe hundës me maskë për të rriturit

Gjatë fazës së Kuqe të semaforit zbatohen rregullat si vijon:

Përsëri lani duart, mbani distancën, mbulimi i gojës dhe hundës me maskë për të rriturit

Funksionim i kopshtit me kufizime: ju lutemi kini parasysh se gjatë kësaj faze të semaforit, oferta për përkujdesjen ofrohet për ata fëmijë, për të cilët prindërit ose kujdestarët ligjorë nuk e kanë mundësinë e përkujdesjes në shtëpi.

- ➔ Drejtoria e kopshtit do t'ju informojë në kohën e duhur për situatën aktuale në kopshtin tuaj të fëmijëve dhe për proceset organizative.
- ➔ Prindërit ua përcjellin fëmijëve të tyre sigurinë dhe besimin. Prandaj, nëse keni ndonjë pyetje dhe paqartësi, drejtojeni drejtorisë së kopshtit ose edukatores / edukatorit pëkatës.

Zyra e qeverisë së krahinës të Austrisë së Ulët të (NÖ), departamenti i kopshteve për fëmijë, gusht 2020

Unë e kam kuptuar dhe do ta zbatoj informacionin për përshtatjen e fëmijës me kopshtin duke respektuar masat paraprake mbrojtëse për Coronën.

Emri:

Data, Nënshkrimi: